

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT



DIVERSITETI I TITUJVE EKZEKUTIVË NË
MBLEDHJEN E BORXHEVE NDËRKUFITARE NË BE



Project EU-En4s - JUST-AG-2018/JUST-JCOO-AG-2018
Funded by the European Union's Justice Programme
(2014-2020)

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Një ndër pengesat e shumta të hasura në ekzekutimin ndërkufitar të titujve ekzekutivë, ndoshta më e dukshme është mungesa e besimit reciprok ndërmjet autoriteteve kombëtare të Shteteve të ndryshme Anëtare të BE-së. Autoritetet kombëtare i trajtojnë titujt ekzekutivë të shteteve të tjera anëtare me hezitim dhe mosbesim. Ky problem rëndohet nga diversiteti i titujve ekzekutivë në shtete të ndryshme anëtare, kryesisht struktura dhe efekti i tyre. Projekti synon të analizojë këto ndryshime dhe të trajtojë problemet e identifikuar, me qëllimin kryesor që të forcojë besimin reciprok.

PIKA KYÇE RRETH EU-EN4S

- 1 Konsorciumi është i përbërë nga 15 partnerë nga BE dhe 1 partner Vend Kandidat.
- 2 Hulumtim krahasues në vendimet gjyqësore, zgjidhjet gjyqësore dhe aktet noteriale.
- 3 Hulumtim mbi kornizën ligjore Europiane për ekzekutimin ndërkufitar në çështje civile dhe tregtare.
- 4 Gjetjet unike, të cilat do të lehtësojnë qarkullimin e vendimeve gjyqësore në BE.
- 5 Integrimi i mjeteve të Teknologjisë së Informacionit për të ndihmuar të interesuarit në një kuptim sa më të mirë të titujve të huaj ekzekutivë.
- 6 Prospekte të ekzekutimit automatik ndërkufitar.

DIVERSITETI I TITUJVE EKZEKUTIVË PËR ÇFARË BËHET FJALË?

Titujt ekzekutivë variojnë nga njëri Shtet Anëtar të BE-së në tjetrin. Ata ndryshojnë në mënyrë të gjerë, përfshirë emërtimin, llojin e vendimit, strukturën dhe efektet.

E drejta e BE-së nuk trajton harmonizimin e titujve ekzekutivë kombëtarë të vërtetë. Kështu që, e drejta kombëtare në mënyrë autonome përcakton karakteristikat e titujve ekzekutivë.

NJË ANALIZË KRAHASUESE DO TË PËRPIQET TË IDENTIFIKOJË NDRYSHIMET DHE NGJASHMËRITË NË 3 KATEGORI TË DALLUESHME TË TITUJVE EKZEKUTIVË

VENDIME
GJYQËSORE

ZGJIDHJE
GJYQËSORE

AKTE NOTERIALE TË
EKZEKUTUESHME

Partnerët kanë venë në dispozicion shembuj të titujve ekzekutivë kombëtarë, si dhe kontribute praktike dhe teorike mbi procedurën e Shtetit Anëtar përkatës. Ata do të analizojnë dhe identifikojnë pika të debatueshme në lidhje me titujt e huaj ekzekutiv. Partnerët do të kenë për qëllim të gjejnë zgjidhje për çështje aktuale të debatueshme dhe të paqarta, në mënyrë që të sjellin më shumë qartësi mbi këtë objekt diskutimi, me qëllimin final të përmirësimit të besimit reciprok në Shtetet Anëtare.

EFEKTET E TITUJVE EKZEKUTIVË NJË TEMË SHUMËPLANËSHE

Sipas Rregullores Bruksel Ia, një vendim gjyqësor i ekzekutueshëm në një Shtet Anëtar të origjinës duhet të jetë i ekzekutueshëm edhe në një Shtet Anëtar ku drejtohet.

Studimi do të japë një vështrim gjithëpërfshirës të efektit të “zbatueshmërisë/ekzekutueshmërisë” në një kuadër kombëtar dhe krahasues. Është e rëndësishme të shtjellohen parakushtet të cilat çojnë në ekzekutueshmërinë dhe të veçohet ekzekutueshmëria nga forma e prerë e vendimit gjyqësor (nëse është e mundur). Hulumtimi mbi marrëdhënien mes të dyjave është shpesh ose i marginalizuar ose krejtësisht i injoruar në doktrinat respektive të juridiksioneve kombëtare.

Vëmendje e veçantë i kushtohet pasojave të res judicata (gjësë së gjykuar). Një vlerësim krahasues mbi kufijtë personalë dhe dimensionet objektive dhe kohore të gjësë së gjykuar do të ndërmerret, shoqëruar me një analizë shteruese të nocionit të “shkakut të padisë” sipas të drejtës kombëtare.

Përfundimet krahasuese do të marrin në konsideratë qasjet e ndryshme ndaj ‘gjësë së gjykuar’ sipas sistemeve të së drejtës civile, common law dhe të drejtës së BE-së. Të gjitha zbulimet do të japin një themel të shkëlqyer për të nxjerrë përfundime në kontekstin ndërkufitar. Aktet noteriale janë të ekzekutueshme sipas kërkesave të ngurta materiale dhe i nënshtrohen rregullave të rrepta mbi formën, të cilat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme mes Shteteve Anëtare.



NDRYSHIMET STRUKTURORE PSE JANË TË RËNDËSISHME?



Gjyqtarët ose përmbaruesit mund të kenë vështirësi kur palët përpiqen të ekzekutojnë një titull të huaj ekzekutiv. Për shembull, identifikimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor mund të jetë i vështirë, nëse dispozitivi nuk është shkruar në një pjesë më vete, por është i ndërthurur me pjesën arsyetuese të vendimit, ose nëse specifikimi i padisë është i gjithi i rezervuar për një vendim gjyqësor pasardhës.



Për më tepër, llogaritja e interesave mundet që shpesh të jetë sfiduese nëse titulli ekzekutiv nuk e specifikon si kohëzgjatjen ashtu edhe interesin e pretendimit.



Identifikimi i saktë i kreditorit dhe debitorit prej titullit ekzekutiv merr rëndësi në rastet e zëvendësimit të palëve, si dhe në vendimet gjyqësore me efekte mbi të drejta reale (in rem).



Titujt e huaj ekzekutivë mund të përmbajnë karakteristika, si dhe masa ekzekutuese të panjohura në Shtetin Anëtar ku drejtohen.



Dallimi i pjesës disponuese të vendimit gjyqësor si dhe baza ligjore dhe faktike e arsyetimit të vendimit mund të paraqesë një sfidë. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për ndalimin e revision au fond (rishikimin thelbësor).

NË KONTEKSTIN NDËRKUFITAR

Aktivitetet kërkimore adresojnë shumë çështje të pazgjidhura në kontekstin ndërkufitar. Këto nuk janë të kufizuara në sferën e njohjes dhe ekzekutimit, por kanë të bëjnë edhe me juridiksionin.

Duke filluar me konceptet themelore të një “vendimi gjyqësor” dhe “instrumenti autentik”, projekti ka për qëllim të sigurojë një katalog të detajuar të vendimeve dhe instrumenteve kombëtare, të cilat i konformohen homologëve të tyre euro-autonome.

Projekti ka për qëllim të hedhë dritë mbi konceptet iluzive të “padive të lidhura” sipas Rregullores Bruksel Ia. Përvojat kombëtare dhe qëndrimet teorike do të ndihmojnë të identifikohen situata ngushtësisht të lidhura që i japin shkas “papajtueshmërisë” së vendimeve gjyqësore.

Koncepti i vendimeve gjyqësore të “papajtueshme” do të eksplorohet gjerësisht për qëllime të përcaktimit të lis pendens dhe ne bis in idem ndërkombëtare.

Një aspekt shoqërues i këtij problemi është manifestuar më tej në konceptin problematik të “padive torpedo”, të cilat janë ende një rezultat i mundshëm sipas Rregullores Bruksel Ia dhe kështu që kërkojnë vëmendje.

Kërkimi doktrinor do të sjellë njohuri të çmuara mbi shtrirjen e efekteve të vendimeve gjyqësore (fusha e zbatimit të autoritetit të tij dhe efektiviteti në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës).

Në kontekstin e zbatueshmërisë, projekti do të trajtojë marrëdhënien dhe pabarazitë e mundshme ndërmjet certifikatave të ekzekutueshmërisë (urdhrit të ekzekutimit) dhe titullit ekzekutiv. Kjo mund të jetë veçanërisht shqetësuese dhe të nxisë autoritetin zbatues të marrë njoftim mbi titullin ekzekutiv në vend të certifikatës (urdhrit të ekzekutimit).



PËRPARIMI I QARKULLIMIT TË VENDIMEVE

GJYQËSORE NË EPOKËN DIGJITALE

EU-En4s nuk shmang përballjen me sfidat dhe mundësitë e digjitalizimit. Dy rezultate janë disenjuar për të ndihmuar pjesëmarrësit në ekzekutimin ndërkufitar.

1

Orakull i Prototipit të një Titulli Ekzekutiv. Një mjet interaktiv, që karakterizon vendimet nga Shtetet Anëtare, me informacion të dobishëm, praktik dhe teorik mbi strukturën dhe efektet.

2

Hulumtim mbi perspektivat e procedimit të ekzekutimit automatik. Shumë Shtete Anëtare ndërkohë operojnë me disa forma të procedurave të ekzekutimit elektronik. Projekti do të përpilojë format e përdorura në këto procedura dhe do të përpiqet të demonstrojë dobishmërinë në hapa individualë.

AKTIVITETE TË KRYERA

- ✓ Takimi i parë pranë Universitetit të Mariborit, Slloveni
- ✓ Takimi i ekspertëve pranë UCLan, Qipro
- ✓ Mbledhje pune kombëtare në secilin Shtet Pjesëmarrës.
- ✓ Pyetësi i projektit i hartuar
- ✓ Raportet Kombëtare të hartuara
- ✓ Konferenca e Parë Ndërkombëtare në Protoroz, Slloveni

AKTIVITETE TË ARDHSHE PËR T'U KUJTUAR


- Konferenca e Dytë Ndërkombëtare në 2021
- Orakull i Titullit Ekzekutiv Prototip
- Vlerësimi Krahasues Ndërkombëtar
- Raporti Final i Ekspertëve



Kërkimi shkencor drejtohet nga Universiteti i Mariborit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Instituti i tij për të Drejtën Civile, të Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private, i cili ka një eksperiencë të gjerë në projekte të ngjashme në fushën e ekzekutimit ndërkufitar.



INFORMACIONE TË MËTEJSHME

 www.pf.um.si/en/acj/projects/pr09-eu-en4s/

 @EUN4s


 @En4sEu

KOORDINATOR I PROJEKTIT

prof. dr. Vesna Rijavec

@ vesna.rijavec@um.si

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Mariborit
Instituti për të Drejtën Civile, të Krahasuar dhe
Private Ndërkombëtare

 Mladinska ulica 9
2000 Maribor, Slloveni



NOTARSKA
ZBORNICA
SLOVENIJE

 inštitut za primerjalno pravo



 Maastricht University



UNIVERSITÄT GRAZ
UNIVERSITY OF GRAZ



MYKOLAS ROMERIS
UNIVERSITY


MUNI
FACULTY
OF LAW



UNIVERSIDADE
PORTUCALENSE



zagotovila z učinkor



Faculty of Law

